



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	DPK
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-02/318/18
Data Datum Date	02-02-2018
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.02.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2447/17, për z. Artan Fejza, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Artan Fejza, Udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike dhe njëkohësisht person i autorizuar, në biznesin privat N.T.Sh "Kosova News Network", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se biznesi nuk zhvillon aktivitet, por vetëm ka mbetë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, prandaj z. Fejza ka premtuar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën i është kërkuar të shmang konfliktin e interesit brenda afatit ligjore, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 18 paragrafi 8 të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/209/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

